



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MARRËVESHJE**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Sot, më datë 16.03.2022, Palët e mëposhtme:

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT  
Z. Edi Rama

dhe

**Bashkia Tiranë**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.16, datë 16.03.2022, për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 12 kate mbitokë me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Sami Frashëri”, Bashkia Tiranë”, bien dakord si më poshtë:

**NENI 1**  
**OBJEKTI**

1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit: “Godinë banimi dhe shërbimesh 12 kate mbitokë me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në

rrugën “Sami Frashëri”, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “AL-Konstruksion Group” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.16, datë 16.03.2022.

## **NENI 2 KOHËZGJATJA**

- 2.1 Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Tiranë, nga data e paraqitjes së aplikimit fillestar të subjektit zhvillues për Leje Ndërtimi, deri në datën e lëshimit të Çertifikatës së Përdorimit.

## **NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:


i. Vënien në dispozicion të Bashkisë Tiranë të Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.16, datë 16.03.2022, për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 12 kate mbitokë me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Sami Frashëri”, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “AL-Konstruksion Group” sh.p.k.

dhe

ii. Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, që shoqërojnë këtë Vendim.

- 3.2 Bashkia Tiranë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 12 kate mbitokë me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Sami Frashëri”, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “AL-Konstruksion Group” sh.p.k,
- ii. Shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit përkatës teknik; të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në këtë zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe



palëve të treta, si dhe të çdo akti/dokumenti tjetër ligjor, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

iii. Miratimin dhe lëshimin e akteve/dokumenteve të poshtëshënuara, për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 12 kate mbitokë me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Sami Frashëri”, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “AL-Konstruksion Group” sh.p.k., sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.16, datë 16.03.2022:

- Leje Ndërtimi;
- Certifikatë Përdorimi.

#### NENI 4

#### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

4.1 Palët do t’i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

#### NENI 5

#### GJUHA E MARRËVESHJES

5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

#### NENI 6

#### EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI

6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.

6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

#### PALËT

**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**BASHKIA TIRANË**

Përfaqësuar nga,  
**Z. EDI RAMA**

Përfaqësuar nga,  
**Z. ERION VELIAJ**

